

Prishtinë, 24 qershor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_256_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 2 dhe Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9, të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 20 paragrafi 1 dhe Nenit 24 paragrafi 3 të Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji; dhe
3. Kërkesën për miratimin e Procedurës për leximin dhe faturimin e konsumatorëve tarifor të bërë nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A),

në seancën e mbajtur me 24 qershor 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. MIRATOHET** Procedura e Leximit dhe e Faturimit të konsumatorëve tariforë.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e të Licencuarit - Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A), për miratimin e Procedurës për Lexim dhe faturim të konsumatorëve Tarifor.
2. Pas shqyrtimit të kërkesës së KEK SH.A dhe plotësimit të procedurës me komente shtesë, Bordi i ZRRE-së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.
- II.** I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Procedurë në faqen e tij elektronike.
- III.** Vendimi nxiret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Procedura e leximit dhe e faturimit të konsumatorëve tariforë.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar